



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna Istog/ Opstine Istok/ Municipality of Istog
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



12 Nr.18/2025
Datë: 04.03.2025

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisionit vlerësues
për vlerësimin e aplikimeve të Klubeve Sportive për Kategorizim**

Bazuar në njoftimin e datës **03.03.2025** të publikuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Komuna e Istogut për Kategorizimin e Klubeve Sportive, ftojme përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare/shoqërisë civile dhe ekspertët, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertit të jashtëm.

Rregullorja Komunale Nr.01-179/2024 Rregullore për Kategorizimin e Klubeve Sportive, në nenin 5 paragrafi 1.2, përcakton që pjesë e komisionit vlerësues për vlerësimin e aplikimeve të Klubeve për Kategorizim të pranuar pas njoftimit publik nga ana e DKRS-së, duhet të jetë një anëtarë i jashtëm i dëshmuar në fushën e sportit.

Për këtë qëllim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport fton të gjithë kandidatët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm për të vlerësuar aplikimet për Kategorizim të Klubeve Sportive të paraqitura nga nga vet Klubet pas njoftimit publik të bërë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Angazhimi i ekspertit të jashtëm për procesim e vlerësimit të Klubeve Sportive për Kategorizim është me pagesë në shumën prej 80 euro (tetëdhjetë euro).

Të drejtën për të aplikuar kanë:

- Punonjësit të organizatave joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur me përvojë pune në fushën e sportit;

Aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Duhet të kenë të paktën nivelin e studimeve themelore universitare - Bachelor;
- Dëshmi të përvojës së punës;
- Përvojë dhe njohuri në fushën e aktiviteve sportive;
- Nuk duhet të jenë të emëruar politik, nëpunës civilë ose në pozita të ngjashme në administratën publike;

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Letër motivimi;
- CV e azhurnuar;
- Provat e arsimimit dhe të përvojës së punës;
- Punonjësit e OJQ-ve duhet të paraqesin një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën është i punësuar aplikanti.

I tërë dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet vetëm përmes adresës elektronike (e-mail; drin.sadikaj@rks-gov.net)

Për informacion shtesë mund të njoftoheni me telefon: 046261040

Vetëm kandidatët nga lista e shkurtër do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur 5 ditë pune nga data e publikimit, nga 04.03.2025 deri më 10.03.2025
Aplikacionet që vijnë pas afatit dhe aplikacionet jo të plota do të refuzohen.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoresha:

